

# Drejtuesit kryesorë

## **DAN REDFORD** **- ZËVENDËSKRYETAR I PREZENCËS**

Dan Redford, i dërguar nga Mbretëria e Bashkuar, u bë pjesë e Prezencës së OSBE-së në vitin 2006. Fillimisht, ai shërbeu si Kryekëshilltar për Çështjet Politike, Marrëdhëniet me Publikun dhe Raportimin dhe, më pas, u emërua si Zëvendëskryetar, më 1 korrik 2010. Ka punuar si drejtor për zgjedhjet dhe partitë politike për Institutin Kombëtar Demokratik për Çështjet Ndërkombëtare (NDI) në Shqipëri, gjatë periudhës 2002-2006. Para se të vinte në Shqipëri, ka pasur një karrierë politike në qeverinë vendore në njësinë vendore të Harrouit, Londër, ku ka mbajtur poste të ndryshme ekzekutive. Ka pasur, gjithashtu, edhe poste menaxhuese në *Harrods Food Halls* në Londër. **Kontakti Dan Redford:** [dan.redford@osce.org](mailto:dan.redford@osce.org)

## **JACK BELL** **- SHEF I DEPARTAMENTIT PËR BASHKËPUNIM NË ÇËSHTJET E SIGURISË**

Jack Bell, i dërguar nga Shtetet e Bashkuara, është në këtë post që prej vitit 2005. Ai ka punuar për Misionin e OSBE-së në Gjeorgji gjatë periudhës 2003-2005. Para se të futej në OSBE, ka punuar në Nju Jork, Afganistan dhe Bosnje-Hercegovinë, si dhe ka qenë Drejtues Ekipi në Konferencën Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë në Serbi. Ka shërbyer në Ushtrinë e Shteteve të Bashkuara gjatë periudhës 1979-1994. **Kontakti Jack Bell:** [jack.bell@osce.org](mailto:jack.bell@osce.org)

## **FRANK DALTON** **- SHEF I DEPARTAMENTIT LIGJOR DHE TË DREJTAVE TË NJERIUT**

Frank Dalton, i dërguar nga Shtetet e Bashkuara, u bë pjesë e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri në vitin 2003. Ai është edhe këshilltari ligjor i Prezencës. Para se të futej në OSBE, ka qenë Drejtor Programi për Evropën Juglindore dhe lektor i jashtëm me Projektin për Edukim Qytetar, një OJQ ndërkombëtare që mbështet reformën në mësimdhënien e së drejtës, shkencave shoqërore dhe ekonomikut në universitet. **Kontakti Frank Dalton:** [frank.dalton@osce.org](mailto:frank.dalton@osce.org)

## **DARCIE NIELSEN** **- SHEFE E DEPARTAMENTIT TË MIRËQEVERISJES NË ÇËSHTJET EKONOMIKE DHE MJEDISORE**

Darcie Nielsen, e dërguar nga Shtetet e Bashkuara, është pjesë e Prezencës që prej vitit 2006. Para se të bëhej pjesë e OSBE-së, ajo ka qenë drejtoreshë e një programi për qeverinë vendore të Institutit Kombëtar Demokratik për Çështjet Ndërkombëtare në Turqi. Në Shtetet e Bashkuara, ajo ka qenë një komisioneve e zgjedhur në qeverinë vendore dhe specialiste për përdorimin e tokës dhe planifikimin në bashkëpunim me komunitetin. **Kontakti Darcie Nielsen:** [darcie.nielsen@osce.org](mailto:darcie.nielsen@osce.org)

## **HARTMUT PÜRNER** **- SHEF I DEPARTAMENTIT TË DEMOKRATIZIMIT**

Hartmut Pürner, i dërguar nga qeveria gjermane, është bërë pjesë e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri në korrik 2007. Më parë ai është marrë me kërkime dhe shkrime akademike në Berlin dhe ka qenë vëzhgues afatshkurtër i OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet në Ukrainë dhe Shqipëri.

Ka punuar në Misionin e OSBE-së në Bosnjë-Hercegovinë gjatë periudhës 1997-1999 dhe në Misionin e OSBE-së në Kosovë, gjatë periudhës 2001-2005. **Kontakti Hartmut Pürner:**  
[hartmut.puerner@osce.org](mailto:hartmut.puerner@osce.org)